

VENDIM
Nr. 500, datë 1.8.2012

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 718, DATË 23.6.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË PERSONELIT TË HETIMIT, TË
INSPEKTIMIT DHE TË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE NË SHËRBIMIN E KONTROLLIT
TË BRENDSHËM, NË MINISTRINË E BRENDSHME”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 51 të ligjit nr. 10 002, datë 6.10.2008 “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Brendshme”, të nenit 4 pika 2 të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve” dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 718, datë 23.6.2009, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:
 - a) Lidhja nr. 1 “Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e personelit hetues të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm”, e përmendur në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.
 - b) Lidhja nr. 2 “Struktura dhe nivelet e pagave, për punonjësit civilë inspektues dhe mbështetës të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm”, e përmendur në pikën 6, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.
 - c) Lidhja nr. 3 “Vlera e pagës së grupit për grupet e diplomave të arsimit universitar”, e përmendur në pikën 8, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.
 2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, do të përballohen nga fondet e parashikuara në buxhetin e shtetit për rritjen e pagave, për vitin 2012.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 15 korrik 2012.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha